



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY**

**OSHP: 2024/0333  
Data e Vendimit: 07.05.2024**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik OE “NEW-LINE” SH.P.K. kundër njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “089 - Furnizim me tepiha, perde dhe artikuj tjerë për shkolla dhe institucionet tjera në kuadër të komunës së Skenderajt si dhe mirëmbajtja (pastrimi) i tyre” me numër të prokurimit 643-23-13612-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA SKENDERAJ” zv. Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Agim Sheqiri me datën: 07.05.2024, mori këtë:

**VENDIM**

**I. Hedhet si e palejuar**, ankesa e “NEW-LINE” SH.P.K me nr. të protokollit 2024/0333, e datës 16/04/2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “089 - Furnizim me tepiha, perde dhe artikuj tjerë për shkolla dhe institucionet tjera në kuadër të komunës së Skenderajt si dhe mirëmbajtja (pastrimi) i tyre”, me numër të prokurimit 643-23-13612-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KK SKENDERAJ”.

**II. I lejohet**, autoritetit kontraktues – “KK SKENDERAJ” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “089 - Furnizim me tepiha, perde dhe artikuj tjerë për shkolla dhe institucionet tjera në kuadër të komunës së Skenderajt si dhe mirëmbajtja (pastrimi) i tyre” me numër të prokurimit 643-23-13612-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Në sistemin elektronik ankesa është paraqitur me datë 16.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “089 - Furnizim me tepiha, perde dhe artikuj tjerë për shkolla dhe institucionet tjera në kuadër të komunës së Skenderajt si dhe mirëmbajtja (pastrimi) i tyre” me numër të prokurimit 643-23-13612-1-2-1, iniciuar “KK SKENDERAJ”, në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 08.12.2023, “NEW-LINE” SH.P.K në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë, ku sipas këtij njoftimi afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data: 04.01.2024.

Me 05.04.2024, “KK. SKENDERAJ” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58-Njoftimin mbi Vendimin e AK.

OE “NEW-LINE” SH.P.K me 12.04.2024 OE kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 12.04.2024 AK e ka refuzuar kërkesën e Operatorit Ekonomik si e pa bazuar në bazë të nenit 60.

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave* – Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “089 - Furnizim me tepiha, perde dhe artikuj tjerë për shkolla dhe institucionet tjera në kuadër të Komunës së Skenderajt si dhe mirëmbajtja (pastrimi) i tyre” me numër të prokurimit 643-23-13612-1-2-1, iniciuar nga “KK SKENDERAJ”, njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 08.12.2023, afati i fundit për praninë të tenderëve ishte data 04.01.2024. Ndërsa me datë 12.04.2024 OE “NEW-LINE” SH.P.K kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Autoriteti Kontraktues me datën 12.04.2024 e ka refuzuar kërkesën e Operatorit Ekonomik si e pa bazuar në bazë të nenit 60.

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.2 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtrij kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund të drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 3.2 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzojë tek autoriteti përkatës kontraktues: *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënie*

*e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit. Po ashtu, edhe neni 60.1 pika b) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0) lidhur me nenin 5 të LPP-së.*

Përfundimisht nga shkresat e lëndës konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 16.04.2024, nga OE “NEW-LINE” SH.P.K për aktivitetin e prokurimit “089 - Furnizim me tepiha, perde dhe artikuj tjerë për shkolla dhe institucionet tjera në kuadër të komunës së Skenderajt si dhe mirëmbajtja (pastrimi) i tyre” me numër të prokurimit 643-23-13612-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues AK – “KK SKENDERAJ”, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit në rrethana të tilla sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së, kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 5, 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Megjithatë Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A, 109 dhe të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP. Megjithatë, OSHP gjithnjë nisat nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Prandaj në kuptim të nenit Neni 51 (Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes) të LPP, sipas të cilit të gjithë kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Dhe se, në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji. Andaj Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK se në çdo aktivitet duhet të veprohet sipas dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenet 1,6,7, 27,28,51,59,60, 69 të LPP.

Autoritetit kontraktues – “KK. SKENDERAJ”, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “089 - Furnizim me tepiha, perde dhe artikuj tjerë për shkolla dhe institucionet tjera në kuadër të komunës së Skenderajt si dhe mirëmbajtja (pastrimi) i tyre” me numër të prokurimit

643-23-13612-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP konform nenit 111 të LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, që operatorit ekonomik ankues ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Zv. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

**Vendimi dorëzohet:**

- AK – “KOMUNA SKENDERAJ”
- OE - “NEW-LINE” SH.P.K
- Arkivës së OSHP-së:

Agim Sheqiri  
Zv. Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së

